

RREGULLORJA E STANDARDEVE PROFESIONALE DHE ETIKE

ME qëllim që të arrihet një efikasitet më të mirë në kuadër të aktiviteteve të projekteve, Qendra për Gazetari Hulumtuese do të punojnë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë Rregullore. Të gjitha parimet e punës së organizatës do të rregullohen me këtë pako të rregullave. Ky është një dokument interesant që ka për qëllim t'i përcaktojë rregullat paraprakisht të definuara, me qëllim që aktivitetet e projekteve të realizohen në një bazë profesionale.

ETIKA DHE PROFESIONALIZMI

Gazetarët i përfaqësojnë vlerat demokratike dhe interesin publik me një informim objektiv. Kjo nganjëherë nuk përputhet me interesat e ndryshme grupore ose individuale, duke përfshirë edhe interesat e pushtetit, përfaqësuesve të marketingut dhe nganjëherë edhe pronësorëve të mediave.

Gazetari (gazetarët) nuk do të krijojnë ose nuk do të liferojnë informacione që i rrezikojnë të drejtat dhe lirinë e njeriut; nuk do të përdorin fjalën e urrejtjes dhe nuk do të inkurajojnë dhunën ose diskriminimin në cilëndo bazë (orientimin nacional, fetar, politik, racor, social, lingvistik, seksual...)

Gazetari (gazetarët) duhet të publikojnë informacione të sakta dhe të kontrolluara dhe nuk do të fshehin informacionet kryesore dhe nuk do të falsifikojnë dokumente. Nëse informacioni i gazetarit (gazetarëve) nuk mund të konfirmohet ose në disa raste bëhet fjalë për një supozim ose spekulim, e njëjta gjë duhet të theksohet dhe të publikohet në bashkëpunim me kryeredaktorin dhe avokatin, i cili, po ashtu është pjesë e këtij projekti.

Saktësia e informacioneve duhet të kontrollohet sa më saktë që është e mundur. Gazetari do t'i respektojë dallimet profesionale, politike, gjinore, etnike, kulturore dhe religjioze në Maqedoni.

Gjatë përgatitjes së storjes hulumtuese, gazetari do të duhet ta sigurojë "anën tjetër" në storje, ose, me fjalë të tjera, të sigurojë sa më shumë burime që është e mundur të cilat do të përfshihen në storjen.

Gazetari do të respektojë ligjet e shtetit dhe nuk do të fshehë informacionin që është me interes publik.

Gazetari, në kuadër të aktiviteteve konkrete të projekteve, nuk do të përdorë projektin për të publikuar ose fshehur informacione për interesat privatë. Për këtë qëllim, gazetari i angazhuar në kuadër të aktiviteteve të projekteve nuk do të përdorë cilëndo formë të rryshfetit apo formën e korrupsionit për qëllime personale.

Në kuadër të aktiviteteve konkrete të projekteve nuk është lejuar që motivet komerciale apo motivet e tjera të ndikojnë ndaj lirisë së shprehjes dhe ndaj së drejtës për të informuar opinionin.

Informimi gjatë fatkeqësive natyrore, aksidenteve, tragjedive familjare, sëmundjeve dhe procedurave gjyqësore do të lirohen nga sensacionalizmi.

Gjatë raportimit (informimit) për procedurat gjyqësore do të respektojë prezumimin e pafajësisë. Në këto raste, të gjitha palët e përfshira do të konsultohen dhe nuk do të sugjerohet për rezultatin e mundshëm të procedurës gjyqësore.

Gazetari nuk mund të intervistojë-publikojë dhe fotografijë fëmijë nën moshën 16 vjeçare, pa lejen paraprake të prindërve ose kujdestarëve, përveç në raste kur bëhet fjalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. E njëjta rregull do të vlejë edhe për njerëzit me aftësi të kufizuara dhe persona me invaliditet, në rastet kur ata nuk janë në gjendje për të gjykuar me mençuri.

POLITIKA REDAKTUESE DHE PRODUKSIONI

Gazetari që është i angazhuar në kuadër të aktiviteteve konkrete të projekteve do të veprojë në përputhje me standardet dhe etikën profesionale gazetareske. Gazetari nuk do të publikojë asnjë përmbajtje pa e lajmëruar paraprakisht koordinatoren dhe redaktorin e projektit. Gazetari do të veprojë në përputhje me instruksionet e redaktorit. Gazetari do të përgjegjës vetëm për përmbajtjet e publikuara të storjes hulumtuese.

Gazetari do të bashkëpunojë me kameramanin dhe personelin tjetër teknik, si dhe me aktorët tjetër të përfshirë në projekt, ndërsa të gjithë do të koordinohen nga koordinatori i projektit, i cili do të jetë përgjegjës për përmbushjen e obligimeve profesionale në kuadër të projektin konkret. Të drejtat e autorëve për të gjitha përmbajtjet do të rregullohen në kontratat e lidhura me ekipin e projektit.

PAJISJET

Pajisje teknike që përbëhen nga kamera profesionale dhe amatore, si dhe pajisje të tjera të cilat i ka në dispozicion SCOOP, do t'u jepen për përdorimin personave

të angazhuar në kuadër të aktiviteteve konkrete të projekteve, të cilët janë të detyruar të kujdesen dhe t'i ruajnë pajisjet e dhëna për përdorim. Çdo dëmtim të kamerave do të konsiderohet si një papërgjegjësi të kameramanëve, gjë që do të shkaktojë pasoja ligjore dhe financiare.

Të gjitha dëmtimet eventuale të pajisjeve të shkaktuara nga fatkeqësi, ose nga ndonjë palë tjetër e tretë do të konsiderohet si një faktor rreziku, që nuk mund të parashihet.